

LIGJ
Nr.9943, datë 26.6.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998
“PËR TATIMIN MBI ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14
Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e dispozitave për tatimin mbi të ardhurat personale, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15
Sanksionet

Dënimet administrative për kundërvajtjet për tatimin mbi të ardhurat personale përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31
Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e dispozitave për tatimin mbi fitimin, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përveç mbajtjes së gabuar të llogarive pa pasoja në rezultatin financiar 1, përcaktohen në ligjin

nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 4

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32
Sanksionet

1. Dënimet administrative për kundërvajtjet për tatimin mbi fitimin përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për rastet e shkeljeve, për mbajtje të gabuar të llogarive pa pasoja në rezultatin financiar 1, personat përgjegjës dënohen me gjobë 10 mijë lekë.”.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5806, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**